

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04
Vendosi: Trupi Gjykses I
Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Zhilber Biti
Gjykatës Vladimir Mikula, Gjykatës rezervë
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Data: 13 dhjetor 2022
Pala parashtruese: Mbrojtësi i Specializuar
Gjuha origjinale: Anglishte
Klasifikimi: Konfidencial

PROKURORI I SPECIALIZUAR

KUNDËR

PJETËR SHALËS

Kërkesë për Leje për Apelim
të Vendimit në Lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala

Zyra e Prokurorit të Specializuar:

Aleks Uajting

Mbrojtësi i Viktimave

Sajmon Loz

Maria Radjejovska

Mbrojtja e të Akuzuarit:

Zhan-Lui Zhilisen

Hedi Auini

Leto Kariolu

I. HYRJE

1. Në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji i DHSK-së”) dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), Mbrojtja e z. Pjetër Shala (përkatësisht “Mbrojtja” dhe “i akuzuari”) paraqet Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në Lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala.¹
2. Në Vendimin e Kontestuar, Trupi Gjykues hodhi poshtë Mocionin e Mbrojtjes ku Mbrojtja kërkonte, për shkak se ishin marrë në kundërshtim me të drejtat e të akuzuarit si i dyshuar, përjashtimin e: (a) deklaratave të dhëna nga i akuzuari gjatë intervistës së zhvilluar nga Policia Federale Gjyqësore belge më 14 janar 2016 dhe intervistës së zhvilluar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe Policia Federale Gjyqësore belge më 11 dhe 12 shkurt 2019; (b) incizimit audiovizual të këtyre intervistave; dhe (c) pjesëve të Shënimeve Zyrtare të ZPS-së në lidhje me to që i referohen intervistës së datës 11 dhe 12 shkurt 2019. Trupi Gjykues gjithashtu miratoi pjesërisht Mocionin e Prokurorisë, me të cilin prokuroria kërkonte pranimin si prova të transkripteve të intervistave të vitit 2005 dhe 2007 të zhvilluara nga Zyra e Prokurorit të Tribunalit Penal

¹ KSC-BC-2020-04, F00364COR, Version i Korrigjuar i Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 6 dhjetor 2022 (konfidencial)(“Vendimi i Kontestuar”). Versioni origjinal i Vendimit (F00364) u dorëzua më 6 dhjetor 2022. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-04, F00281, Mocion për Përjashtimin e Provave nga Dosja e Çështjes që do t’i Kalohet Trupit Gjykues, 20 shtator 2022 (konfidencial)(“Mocioni i Mbrojtjes”); KSC-BC-2020-04, F00288, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Mbrojtjes për Përjashtimin e Provave nga Dosja e Çështjes, 30 shtator 2022 (konfidencial); KSC-BC-2020-04, F00299, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Mbrojtjes për Përjashtimin e Provave nga Dosja e Çështjes, 7 tetor 2022 (konfidencial); KSC-BC-2020-04, F00334, Mocioni i Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarit, 1 nëntor 2022 (konfidencial)(“Mocioni i Prokurorisë”); KSC-BC-2020-04, F00358, Përgjigje e Mbrojtjes Ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarit, 24 nëntor 2022 (konfidencial)(“Përgjigja ndaj Mocionit të Prokurorisë”); KSC-BC-2020-04, F00362, Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes ndaj Mocionit për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarit, 29 nëntor 2022 (konfidencial). Mbrojtja vë në dukje se Kërkesa aktuale është protokolluar si konfidenciale meqenëse Vendimi i Kontestuar dhe parashtrimet e lidhura me të janë protokolluar si konfidenciale.

Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), si dhe dokumentacionin lidhur me intervistat e vitit 2016 dhe 2019 në Belgjikë.² Trupi Gjykses pranoi si prova dokumentacionin e TPNJ-së dhe konstatoi se dokumentacioni lidhur me intervistat e vitit 2016 dhe 2019 ishte i pranueshëm.³

3. Me këto, Trupi Gjykses bëri disa gabime në shkelje të të drejtave të të akuzuarit sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) që meritojnë të shqyrtohen.

4. Mbrojtja propozon për leje pikat në vijim:

(i) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor duke mos pranuar se garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së vlejné nga momenti kur personi dyshohet se ka kryer vepër penale dhe jo nga momenti kur ky person akuzohet për vepër penale;

(ii) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor duke mos e interpretuar rregullën 138(2) të Rregullores në përputhje me KEDNJ-në duke kërkuar ekzistencën e “lidhje shkak-pasojë” midis shkeljes së të drejtave të të dyshuarit dhe mbledhjes së provave;

(iii) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik duke gjykuar se i akuzuari ishte informuar mjaftueshëm për natyrën dhe shkakun e dyshimeve kundër tij si dhe për të drejtat e tij para secilës intervistë;

(iv) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe ligjor duke gjykuar se nuk ishin shkelur të drejta e të akuzuarit si i dyshuar në kontekst

² Vendimi i Kontestuar, para. 52, 80, 110.

³ Vendimi i Kontestuar, para. 114.

të secilës intervistë dhe duke konstatuar se dokumentacioni në lidhje me secilën intervistë ishte i pranueshëm;

(v) *Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor dhe faktik duke gjykuar se korniza ligjore e DHSK-së nuk është e zbatueshme në lidhje me secilën intervistë;*

(vi) *Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe ligjor duke gjykuar se i akuzuari kishte hequr dorë nga të drejtat e tij si i dyshuar duke qenë i informuar mirë dhe në mënyrë të qartë në lidhje me secilën intervistë;*

(vii) *Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur ia kishte lënë barrë Mbrojtjes për të provuar sjellje të vullnetshme apo mungesë të veprimeve detyruese;*

(viii) *Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur kishte zbatuar kriterin objektiv nëse i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për të drejtat e tij si i dyshuar para secilës intervistë;*

(ix) *Nëse Trupi Gjykses bëri gabim kur nuk e kishte shqyrtuar apo nuk kishte zbatuar kriterin objektiv gjatë vlerësimit nëse i akuzuari kishte qenë në gjendje të parashihte pasojat e veprimeve të veta në lidhje me secilën intervistë; dhe*

(x) *Nëse Trupi Gjykses bëri gabim kur nuk e kishte shqyrtuar Mocionin e Mbrojtjes për Përrjashtim të Provaëve dhe kur nuk kishte dhënë vendim të arsyetuar mirë për hedhjen poshtë të tij.*

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Neni 45(2) i Ligjit të DHSK-së dhe rregulla 77 e Rregullores përmbajnë kriterin ligjor për leje për apelim të ndërmjetëm përmes autorizimit. Pala që kërkon autorizim duhet të demonstrojë ekzistencën e pikës që: (i) ndikon në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave apo rezultatin e gjykimit, përfshirë rastet kur nuk mund të miratohen mjete juridike të përshtatshme pas përmbylljes së çështjes në gjykim; dhe (ii) zgjidhja e menjëhershme e të cilës nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të avancojë qenësisht procedurat.
6. Që një “pikë” të jetë e apelueshme, duhet të ketë lidhje me një pikë të veçantë që buron nga Vendimi i Kontestuar dhe nuk ka të bëjë me pyetje abstrakte apo shqetësime hipotetike, apo vetëm me mospajtime me vendimin.⁴

III. PARASHTRIMET

A. Pikat janë të apelueshme

7. Mbrojtja parashtron se pikat janë të sakta, konkrete, dhe dalin drejtpërdrejt nga Vendimi i Kontestuar.
8. Të gjitha pikat kanë të bëjnë me të drejtat themelore të të akuzuarit, dhe në mënyrë që ai të gëzojë plotësisht të drejtën për gjykim të drejtë dhe t’i jepen mjete juridike efektive që garantojnë që këto procedura të zhvillohen në mënyrë të drejtë, duhet të miratohet autorizimi për apelin e pikave në vijim.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00172, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel, 11 janar 2011, para. 11.

i. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur pranoi se garancitë e nenit 6 të Konventës hyjnë në fuqi në momentin kur personi dyshohet se ka kryer veprë penale dhe jo kur akuzohet për veprë penale

9. Në paragrafin 24 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses "rikujton se, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, personi i 'i akuzuar për veprë penale', siç është personi që merret në pyetje për përfshirje në veprë penale, mund të kërkojë mbrojtje sipas nenit 6 të [KEDNJ-së]". Në paragrafin 26 të Vendimit të kontestuar, Trupi Gjykses thotë se "të dyshuarit duhet t'i jepet ndihmë juridike që nga momenti i ngritjes së 'akuzës penale' kundër tij në përputhje me nenin 6(3)(c) të Konventës Evropiane".
10. Trupi Gjykses konstatoi gabimisht se garancitë e përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ-së, përfshirë të drejtën për përfaqësim juridik, vlejné vetëm "nga momenti kur bëhet 'akuza penale'".⁵ Dhoma e Madhe (Grand Chamber) e GJEDNJ-së, përfshirë çështjet *Ibrahim dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Beuze kundër Belgjikës*, vazhdimisht ka vlerësuar se "me nenin 6 (1) kërkohet që, në parim, e drejta për avokat duhet të plotësohet që nga marrja e parë në pyetje nga policia".⁶ Në mënyrë që garancitë e nenit 6 të jenë efektive, ato duhet të zbatohen në kontekst të çfarëdo ndërveprimi të rëndësishëm të të dyshuarit me autoritetet dhe sidomos në lidhje me intervistat e para. Kjo është jurisprudencë e pranuar gjerësisht dhe qëndrimi i Trupit Gjykses, duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndikimin në drejtësinë e këtyre procedurave në tërësi, meriton të shqyrtohet nga apeli. Kjo për arsyen se qëndrimi i Trupit Gjykses në lidhje me atë se nga cili moment zbatohet neni 6 i bën joefektive garancitë e nenit 6 sa i përket të drejtave të të dyshuarit.

⁵ Vendimi i Kontestuar, para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimi i Kontestuar, para. 24.

⁶ GJEDNJ, *Salduz v. Turkey* [GC], no. 36391/02, 27 nëntor 2008, para. 55. *Shih gjithashtu Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], nos. 50541/08, 50571/08, 50573/08 dhe 40351/09, 13 shtator 2016, para. 256, 258; *Beuze v. Belgium* [GC], no. 71409/10, 9 nëntor 2018, para. 137.

11. Me të gjithë respektin e merituar, Mbrojta parashtron se, për shkak se Trupi Gjykses e ka kuptuar gabimisht ligjin e zbatueshëm, kjo e ka shtyrë të bëjë gabime gjatë zbatimit të tij dhe vlerësimit të rrethanave të paraqitura në mocionet përkatëse dhe gjatë shqyrtimit nëse janë shkelur të drejtat e të akuzuarit si i dyshuar. Këto gabime janë shtjelluar në argumentet në mbështetje të kërkesës për autorizimin e pikave të apelueshme në vijim.

ii. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur nuk e interpretoi rregullën 138(2) të Rregullores në përputhje me KEDNJ-në duke kërkuar ekzistencën e "lidhjes shkakore" midis shkeljes së të drejtave të të dyshuarit dhe mbledhjes së provave

12. Trupi Gjykses ka gabuar kur ka kërkuar "lidhjen shkakore" midis shkeljes së të drejtave të të akuzuarit dhe mbledhjes së provave të kontestuara si dhe në vlerësimin se nuk ka lidhje shkakore në rrethanat konkrete të intervistës së vitit 2016.⁷

13. Në Vendimin e Kontestuar rregulla 138(2) e Rregullores interpretohet në atë mënyrë që kërkohet "lidhja shkakore midis shkeljes dhe mbledhjes së provave".⁸ Ky kriter nuk ka bazë në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe nuk është në përputhje me KEDNJ-në dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"), e cila nuk përmban kriterin e tillë të "lidhjes shkakore".⁹ Në fakt, GJEDNJ-ja (i) ka vlerësuar

⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 20, 78.

⁸ Vendimi i Kontestuar, para. 20, 78.

⁹ GJEDNJ, *Salduz v. Turkey* [GC], para. 55; ECtHR, *Panovits v. Cyprus*, no. 4268/04, 11 dhjetor 2008, para. 66, 73, 75, 77, 84, 85; *Çimen v. Turkey*, no. 19582/02, 3 shkurt 2009, para. 26-28; *Amutgan v. Turkey*, no. 5138/04, 3 shkurt 2009, para. 18-20; *Aslan and Demir v. Turkey*, nos. 39840/02 dhe 5197/03, 17 shkurt 2009, para. 9-11; *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, no. 39660/02, 18 shkurt 2010, para. 37; *Shabelnik v. Ukraine*, no. 16404/03, 19 shkurt 2009, para. 52; *Merahi v. France*, no. 38288/15, 20 shkurt 2022, paras. 76, 77, 88-90. *Shih gjithashtu Imbrioscia v. Switzerland*, no. 13972/88, 24 nëntor 1993, para. 36; ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, Case No. IT-96-21-T, Vendim mbi Mocionin e Zdravko Muciqit për Përfashtimin e Provave, 2 shtator 1997, para. 50, 51.

vazhdimisht se të drejtat e të akuzuarit “do të cenohen në mënyrë të pariparueshme kur deklaratat fajësuese të dhëna gjatë marrjes në pyetje nga policia pa praninë e avokatit përdoren për dënimin e të akuzuarit”; dhe (ii) ka kërkuar “arsye bindëse” për të justifikuar kufizimin e të drejtës për avokat.¹⁰

14. Arsyetimi i Trupit Gjykses që është dhënë në mbështetje të konstatimit se “produkti i dokumentacionit të Intervistës Belge të vitit 2016 [nuk] është marrë ‘nëpërmjet’ shkeljes së të drejtës së tij për avokat brenda kuptimit të përgjithshëm të rregullës 138(2) të Rregullores” bazohet vetëm në deklaratat e mëvonshme të të akuzuarit në vitin 2019.¹¹ Sidoqoftë, deklaratat e mëvonshme të të akuzuarit gjatë intervistës së vitit 2019 (të cilat ishin marrë gjithashtu kur ai nuk kishte përfituar nga përfaqësimi juridik as para e as gjatë intervistës në fjalë) nuk ndikojnë në atë nëse të drejtat e tij si i dyshuar ishin respektuar në kontekst të intervistës së vitit 2016.¹² Prandaj, edhe vendosja e “kriterit” të “lidhjes shkakore” edhe mënyra në të cilën është zbatuar kriteri meritojnë shqyrtim nga apeli sa i përket pajtueshmërisë me nenin 6 të GJEDNJ-së dhe të drejtës për gjykim të drejtë.

iii. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe ligjor kur vlerësoi se i akuzuari ishte informuar mjaftueshëm për natyrën dhe shkakun e dyshimeve kundër tij si dhe të drejtave të tij si i dyshuar para intervistës

(a) Intervistat e TPNJ-së

15. Në paragrafin 32 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka konstatuar se njoftimi i dhënë në fillim të Intervistës së TPNJ-së të vitit 2005 se “ai mund të jetë i dyshuar për kryerjen e veprave për të cilat mund të ngrihen akuza sipas

¹⁰ GJEDNJ, *Salduz v. Turkey* [GC], para. 55; *Çimen v. Turkey*, para. 27; *Ibrahim and Others v. The United Kingdom* [GC], para. 256-258; *Beuze v. Belgium* [GC], para. 142, 161.

¹¹ Vendimi i Kontestuar, para. 78.

¹² Vendimi i Kontestuar, para. 78, 79.

ligjit të TPNJ-së” “mjaftonte në atë kohë për ta informuar të akuzuarin në pika të përgjithshme për natyrën dhe shkakun e dyshimeve dhe pretendimeve kundër tij, si i dyshuar”. Në paragrafin 38 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka konstatuar se i akuzuari ishte informuar plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar në kontekst të Intervistës së TPNJ-së të vitit 2005. Në paragrafin 39, Trupi Gjykses ka konstatuar se, për qëllimet e intervistës së vitit 2005, ishin respektuar të drejtat e tij si i dyshuar.

16. Në paragrafin 42, Trupi Gjykses e ka pranuar se ftesa e dërguar të akuzuarit për t’u paraqitur për Intervistën e TPNJ-së të vitit 2007 vetëm bënte të ditur se “ai ishte i dyshuar për krime lufte”. Në të njëjtin paragraf, Trupi Gjykses pranon se ai ishte njoftuar vetëm “gjatë intervistës” se dyshohej për “transferimin e një personi në mbajtje, ku ishte vrarë më vonë”. Sidoqoftë, për shkak se ishte informuar se konsiderohej “i dyshuar”, “se deklaratat e tij mund të përdreshin kundër tij, dhe se do të kishte mundësi gjatë intervistës t’i komentonte ato” si dhe fakti që ishte njoftuar më parë “për natyrën dhe shkakun e dyshimeve dhe pretendimeve kundër tij” gjatë intervistës së mëparshme në TPNJ, ai ishte i njoftuar mjaftueshëm për “natyrën dhe shkakun e dyshimeve ose pretendimeve kundër tij”.
17. Në paragrafin 49, Trupi Gjykses ka konstatuar se i akuzuari ishte njoftuar plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar në kontekst të Intervistës së TPNJ-së të vitit 2007. Në paragrafin 50, Trupi Gjykses ka konstatuar se ishin respektuar të drejtat e tij si i dyshuar për qëllime të asaj interviste.
18. Ka një problem rrënjësor me kriterin e zbatuar prej Trupit Gjykses për të vlerësuar nëse i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për dyshimet dhe/ose pretendimet kundër tij. Për respektimin e të drejtave të të dyshuarit kërkohet që ai të njoftohet mjaftueshëm për kohën, vendin, dhe veprat konkrete të cilat dyshohet se i ka kryer. Ky njoftim duhet të jepet para intervistës në fjalë dhe jo

gjatë saj. Njoftimi i të dyshuarit vetëm se dyshohet për “krime lufte” apo “vepra për të cilat mund të ngrihen akuza sipas ligjit të TPNJ-së” nuk e përmbush qartë këtë kriter. Fakti që Trupi Gjykses ishte bazuar në njoftimin e parë të pamjaftueshëm për të konstatuar se njoftimet e mëvonshme i respektonin të drejtat e të akuzuarit si i dyshuar e bën këtë gabim edhe më të madh. Në këto rrethana, kriteri që duhet të zbatohet gjatë vlerësimit nëse i akuzuari është njoftuar mjaftueshëm për natyrën dhe shkakun e dyshimeve ose pretendimeve që hetohen meriton ndërhyrjen e apelit.

Intervistat e Belgjikës

19. Mbrojtja parashtron me respekt se Trupi Gjykses ka gabuar kur ka konstatuar se i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për të drejtat e tij dhe natyrën dhe shkakun e dyshimeve kundër tij para intervistës së vitit 2016.¹³ Gjithashtu, njoftimi i dyshimeve të hetuesve nuk ishte aspak i qartë e as i mjaftueshëm dhe i akuzuari nuk ishte njoftuar se kishte të drejtë të kishte këshilla dhe përfaqësim juridik falas gjatë kësaj interviste ose para saj.¹⁴ Gjithashtu, Trupi Gjykses ka gabuar kur nuk ka pranuar se i akuzuari ishte njoftuar për të drejtat e tij vetëm pasi kishte filluar marrja në pyetje gjatë intervistës së vitit 2016.¹⁵ Trupi Gjykses nuk ka shqyrtuar nëse i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për të drejtën e tij për t’u ndihmuar falas nga avokati gjatë intervistës.¹⁶ Gjatë shqyrtimit nëse i akuzuari kishte hequr dorë nga të drejtat e tij gjatë intervistës në fjalë, Trupi Gjykses nuk e ka pranuar se i akuzuari nuk ishte njoftuar për këtë të drejtë.¹⁷

¹³ Vendimi i Kontestuar, para. 73.

¹⁴ Vendimi i Kontestuar, para. 77.

¹⁵ Vendimi i Kontestuar, para. 70, 73, 77.

¹⁶ Vendimi i Kontestuar, para. 70.

¹⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 70 (ku kufizohet shqyrtimi brenda faktit nëse ai ishte njoftuar “për të drejtën për t’u konsultuar në mënyrë konfidenciale me avokatin” dhe jo nëse ishte njoftuar nëse për të drejtën të ndihmohej nga avokati gjatë intervistës në fjalë).

20. Trupi Gjykues gjithashtu ka gabuar kur ka kufizuar vlerësimin e vet të parashtrimeve të Mbrojtjes për këtë pikë (dhe kur i ka shtrembëruar këto parashtrime) në faktin se ligji belg “parasheh vetëm të drejtën për t’u konsultuar me avokatin në mënyrë konfidenciale para intervistës me policinë”¹⁸ dhe nuk i ka shqyrtuar parashtrimet e Mbrojtjes se ekziston obligimi, që shkon përtej ligjit belg, për të njoftuar mjaftueshëm të dyshuarin për të drejtën për përfaqësim juridik falas gjatë intervistës me policinë.¹⁹ Trupi Gjykues ka konstatuar se “në përgjithësi, i akuzuari nuk është parandaluar që të kontaktojë me avokatin”²⁰ duke mos ofruar justifikim të arsyetuar për këtë qëndrim dhe duke mos zbatuar jurisprudencën e pranuar gjerësisht me të cilën përcaktohet se autoritetet hetuese kanë obligim të qartë që ta njoftojnë të dyshuarin për të drejtat e tij.²¹ Në vend se të shqyrtojë nëse autoritetet hetuese kishin respektuar këtë obligim, Trupi Gjykues ka konstatuar se mjaftonte fakti që nuk ia kishin “ndaluar komunikimin me avokat”.²² Kjo përbën shkelje të standardeve të së drejtë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Edhe pse i akuzuari ishte njoftuar për të drejtën që të konsultohet me avokat para intervistës, fakti është që ai nuk ishte njoftuar asnjëherë për të drejtën të ketë avokat të pranishëm gjatë intervistës në fjalë. Fakti që, gjatë intervistës së vitit 2016, ishte informuar për të drejtën të ketë avokat, tregon qartë se nuk ishte respektuar e drejta e tij në mënyrë reale dhe efektive meqenëse intervista kishte filluar pa praninë e avokatit. I akuzuari nuk e kishte ditur se kishte të drejtë të ketë avokat; nuk i kishin thënë se intervista mund të ndërpritej dhe vazhdonte vetëm në praninë a avokatit, asnjëherë nuk ishte njoftuar për të drejtën të ketë

¹⁸ Vendimi i Kontestuar, para. 77.

¹⁹ *Shih, për shembull*, Përgjigje ndaj Mocionit të Prokurorisë, para. 12, 20, 22, 29, 31, 56, 66, 84.

²⁰ Vendimi i Kontestuar, para. 77.

²¹ *Shih, për shembull*, GJEDNJ, *Panovits v. Cyprus*, no. 4268/04, 11 dhjetor 2008, para. 66, 73, 75, 77, 84, 85.

²² Vendimi i Kontestuar, para. 77.

përfaqësim juridik falas gjatë intervistës. Të drejtat e tij si i dyshuar ishin shkelur.

21. Trupi Gjykses ka gabuar kur ka konstatuar se i akuzuari ishte informuar mjaftueshëm për arsyet se pse intervistohet si dhe për të drejtat e tij si i dyshuar para dhe gjatë Intervistës Belge të vitit 2019 kur ishte njoftuar për të drejtat e tij në formën e “frazave të zakonshme” prej oficerit që e kishte për detyrë ta njoftonte për të drejtat e tij para fillimit të intervistës dhe duke pasur parasysh provat e qarta që tregonin hutinë e tij në lidhje me faktin se kishte të drejtë të ketë avokat falas.²³
22. Edhe pse Trupi Gjykses nuk kishte zbatuar ligjin belg,²⁴ veprimet e autoriteteve belge ishin në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm belg dhe garancitë që i jepeshin të dyshuarve në atë kohë.²⁵ Siç theksohet në udhëzime, përshkrimet e mjegullta (p.sh., “vjedhje”, “hyrje e paligjshme në ndërtesa”) nuk do të mjaftonin për qëllime të ligjit. I njëjti kriter vlen për informacionin që përmban fletëthirrja.

²³ Vendimi i Kontestuar, para. 101, 104.

²⁴ Vendimi i Kontestuar, para. 68 (« Trupi Gjykses kështu do ta shikojë ligjin belg vetëm për aq sa është e domosdoshme për të shqyrtuar nëse Intervista Belge e vitit 2016 ishte kryer në pajtim me standardet e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut »).

²⁵ CIRCULAIRE N° 8/2011 DU COLLEGE DES PROCUREURS GENERAUX PRES LES COURS D'APPEL, 23 shtator 2011 lëshuar nga President du College des Procureurs Generaux, II. A. 4. (“*Droit à une information succincte concernant les faits sur lesquels la personne sera entendue*”). Udhëzimet mund të shihen në <https://www.ommp.be/fr/savoir-plus/circulaires>. Konkretisht, siç thuhet në udhëzimet e lëshuara nga *Collège des procureurs généraux* i Belgjikës (Shefi i Prokurorëve të Përgjithshëm) për interpretimin e nenit 47bis, Kapitulli IV, Libri 9 i Kodit të Procedurës Penale, që ishin të obligueshëm për të gjitha autoritetet prokuroriale dhe policore në Belgjikë në kohën kur u zhvilluan të dy intervistat në Belgjikë, në pajtim me të drejtën e të dyshuarit për t'u njoftuar për natyrën dhe shkaqet e dyshimeve apo pretendimeve kundër tij, kërkohet që ai të marrë një përshkrim të shkurtër (“*information succincte*”) të fakteve për të cilat personi do të merret në pyetje, në atë mënyrë që t'i mundësojë të dijë se për cilat çështje do të merret në pyetje, duke i saktësuar së paku disa rrethana të caktuara (p.sh., kohën, vendin, ngjarjet themelore).

iv. Nëse Trupi Gjykes bëri gabim faktik dhe ligjor kur gjykoi se të drejtat e të akuzuarit si i dyshuar nuk ishin shkelur në kontekst të secilës intervistë dhe kur ka konstatuar se dokumentacioni i secilës intervistë ishte i pranueshëm

Intervistat e TPNJ-së

23. Në paragrafin 52 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykes ka pranuar intervistat e TPNJ-së si prova, duke konstatuar se vlera e tyre provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, përkundër shkeljes së të drejtave të të akuzuarit si i dyshuar.
24. Mbrojtja parashton me respekt se Trupi Gjykes ka gabuar në konstatimin për mungesë të detyrimit edhe në kuptimin e kriterit ligjor të përdorur edhe në vlerësimin e rrethanave përkatëse dhe ankesës për shkeljen e të drejtave të të akuzuarit si i dyshuar në lidhje me secilën intervistë.²⁶ Kjo është e vërtetë në veçanti duke pasur parasysh faktin se i akuzuari ishte intervistuar pa iu dhënë mundësi efektive që të konsultohet me avokat para secilës intervistë ose gjatë secilës intervistë, si dhe pabarazinë e qartë që ekzistonte kur i akuzuari merrej në pyetje pa pasur ndihmën e avokatit në lidhje me pjesëmarrjen e tij të pretenduar në krime lufte nga një ekip i hetuesve dhe prokurorëve me përvojë.

Intervistat Belge

25. Në paragrafin 80, Trupi Gjykes ka konstatuar se të drejtat e të akuzuarit si i dyshuar ishin respektuar mjaftueshëm për qëllimet e intervistës së vitit 2016 dhe se intervista në fjalë dhe dokumentacioni përcjellës ishin të pranueshëm.

²⁶ Vendimi i Kontestuar, para. 22, 24, 30, 32, 36, 43, 49.

26. Në paragrafin 109 dhe 110, Trupi Gjykses ka konstatuar se i akuzuari kishte qenë në gjendje të ushtrojë të drejtat e veta si i dyshuar gjatë intervistës së vitit 2019 në mënyrë praktike dhe efektive dhe se, prandaj, intervista e vitit 2019 është e pranueshme.
27. Ngjashëm me argumentet e shtruar më lart lidhur me intervistat e TPNJ-së, Mbrojtja parashtron me respekt se Trupi Gjykses ka gabuar në konstatimin në lidhje me mungesën e detyrimit edhe në kuptimin e kriterit ligjor të përdorur edhe në vlerësimin e rrethanave përkatëse dhe ankesës për shkelje të të drejtave të të akzuarit si i dyshuar në lidhje me secilën intervistë.²⁷ Kjo është veçanërisht e vërtetë duke pasur parasysh faktin se i akuzuari ishte marrë në pyetje pa iu dhënë mundësi efektive që të konsultohet me avokat para secilës intervistë ose gjatë tyre, si dhe pabarazinë e qartë që ekzistonte kur i akuzuari ishte marrë në pyetje pa pasur ndihmën e avokatit në lidhje me pjesëmarrjen e tij të pretenduar në krime lufte nga një ekip i hetuesve dhe prokurorëve me përvojë.

v. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor dhe faktik kur gjykoi se korniza e DHSK-së nuk ishte e zbatueshme sa i përket intervistave

28. Në paragrafin 23 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka konstatuar se “Materiali nuk ishte marrë në bazë të Ligjit dhe rregullores” sepse “intervistat në fjalë ishin kryer ose nga hetuesit e TPNJ-së sipas Statutit dhe Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së, ose nga Policia Federale Gjyqësore belge në bazë të ligjit vendor, dhe jo nga ZPS-ja”. Në bazë të kësaj, Trupi Gjykses ka konstatuar se Materiali nuk ishte marrë sipas Ligjit dhe Rregullores [të DHSK-së] dhe ka vlerësuar “nëse secili dokumentacion i intervistës ishte marrë në

²⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 22, 24, 30, 32, 36, 43, 49.

kundërshtim me *standardet e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*”, duke konstatuar kështu se korniza e DHSK-së është e pazbatueshme.

29. Mbrojtja parashtron me respekt se Trupi Gjykes ka bërë gabim ligjor dhe faktik duke gjykuar se korniza e DHSK-së ishte e pazbatueshme sa i përket të katër intervistave. Kjo është veçanërisht e vërtet sa i përket intervistës së vitit 2019, meqë Trupi Gjykes ka pranuar se i akuzuari ishte marrë në pyetje “me kërkesën e DHSK-së”²⁸ dhe se oficeri i ZPS-së që ishte i pranishëm kishte marrë pjesë aktive në marrjen në pyetje të të akuzuarit. Pjesëmarrja thelbësore e ZPS-së duhet të ishte marrë parasysh gjatë vlerësimit të zbatueshmërisë së kornizës ligjore të DHSK-së.²⁹ Përndryshe, garancitë e përcaktuara në Ligjin dhe Rregulloren e DHSK-së e humbin kuptimin.

30. Mbrojtja parashtron se, edhe nëse gjykohet se konstatimi i Trupit Gjykes se korniza ligjore e DHSK-së nuk ishte e zbatueshme (gjë që Mbrojtja nuk e pranon), Trupi Gjykes e kishte detyrim që ta interpretonte në mënyrë kornizën që kishte zbatuar në përputhje me kornizën e DHSK-së dhe me garancitë e saj për të drejtat e të dyshuarve dhe nuk mund të zbatojë standarde më të ulëta. Kjo pikë meriton shqyrtim nga apeli.

vi. Nëse Trupi Gjykes bëri gabim faktik dhe ligjor kur gjykoj se i akuzuari kishte hequr dorë pasi ishte informuar mirë dhe në mënyrë të qartë për të drejtat e tij si i dyshuar në lidhje me secilën intervistë

31. Trupi Gjykes ka bërë gabim kur nuk ka shqyrtuar nëse i akuzuari kishte hequr dorë pasi ishte informuar mirë dhe në mënyrë të qartë nga të drejtat e tij si i

²⁸ Vendimi i Kontestuar, para. 88.

²⁹ Vendimi i Kontestuar, para. 85. *Shih gjithashtu*, Mocioni i Mbrojtjes, para. 15; Përgjigje ndaj Mocionit të Prokurorisë, para. 41.

dyshuar duke pasur parasysh mangësitë e njoftimit të të drejtave para katër intervistave.

32. Trupi Gjykues e ka përmbysur detyrimin e provës, i cili bie mbi Prokurorinë, për të demonstruar natyrën e vullnetshme të heqjes dorë të pretenduar nga i akuzuari i të drejtës së tij për të pasur avokat dhe mungesën e veprimeve detyruese gjatë marrjes së deklaratës nga i akuzuari.³⁰
33. Trupi Gjykues ka gabuar kur ka përdorur arsyetimin qarkor për të konstatuar se i akuzuari kishte hequr dorë nga të drejtat e tij si i dyshuar në lidhje me secilën intervistë. Për qëllime të intervistës së vitit 2016, Trupi Gjykues e ka bazuar konstatimin se i akuzuari kishte hequr dorë nga të drejtat e veta në faktin se i akuzuari kishte bërë, siç është thënë, deklaratë të “ngjashme” në intervistën e vitit 2019.³¹ Trupi Gjykues pastaj e ka bazuar konstatimin për heqje dorë nga të drejtat në lidhje me intervistën e vitit 2019 në faktin që “në atë fazë, i akuzuari kishte dhënë intervista si i dyshuar para TPNJ-së dhe, në vitin 2016, para Policisë Federale Gjyqësore belge”.³² Arsyetimi qarkor i Trupit Gjykues, që bazohej në faktin se i akuzuari kishte marrë pjesë më parë ose më pastaj në intervista nuk ka ndikim në faktin nëse i akuzuari kishte hequr dorë qartë, shprehimisht ose në mënyrë të heshtur, nga të drejtat e veta si i akuzuar për qëllime të secilës intervistë.
34. Në paragrafin 72 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykues i ka shtrembëruar parashtrimet e Mbrojtjes sa i përket standardeve të zbatueshme në lidhje me vlefshmërinë e heqjes dorë nga të drejtat. Mbrojtja kishte vënë në dukje shprehimisht se “nuk ekziston asnjë heqje dorë të drejtat nga i akuzuari, as e qartë e as e nënkuptuar, që tregon pa mëdyshje se ai kishte hequr dorë nga të

³⁰ *Shih, për shembull, Vendimi i Kontestuar, para. 75.*

³¹ *Vendimi i Kontestuar, para. 78.*

³² *Vendimi i Kontestuar, para. 107.*

drejtat e veta si i dyshuar në lidhje me asnjërën nga katër intervistat”.³³ Mbrojtja kishte argumentuar se, në bazë të kornizës ligjore të DHSK-së, heqja dorë nga të drejtat duhet të bëhet me shkrim.³⁴ Konkretisht, rregulla 43(3) e Rregullores garanton që “heqja dorë nga të drejtat dhe rrethanat në të cilat është bërë dokumentohet me shkrim nga Prokurori i Specializuar dhe nënshkruhet nga i dyshuari.” I akuzuari nuk bëri asnjë heqje dorë nga të drejtat e tij as në formë të qartë e as në formë të nënkuptuar për asnjë nga të katër intervistat.

vii. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur e kishte vënë detyrimin mbi Mbrojtjen për të demonstruar sjellje të vullnetshme apo mungesë të veprimeve detyruese

35. Në paragrafin 22 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka vënë në dukje se “mendon se pala që bën mocion sipas rregullës 138(2) të Rregullores e bart detyrimin të tregojë se janë përmbushur kriteret për përjashtim të provave”. Mocioni i Mbrojtjes për përjashtimin e provave nuk ishte dorëzuar sipas rregullës 138(2) të Rregullores. Sidoqoftë, fakti që Trupi Gjykses iu referua kësaj përmbysjeje të detyrimit të provës në fuqi në pjesën e Vendimit të Kontestuar që përcakton Ligjin Përkatës tregon se Trupi Gjykses e ka zbatuar këtë rregull *mutatis mutandis* gjatë shqyrtimit të rrethanave aktuale. Qasja e Trupit Gjykses konfirmohet nga konstatimet e tij ku kërkon nga Mbrojtja të vërtetojë presion apo detyrim gjatë intervistave.³⁵ Vendimi i Trupit Gjykses nuk është në përputhje me të drejtën për gjykim të drejtë që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, nenin 21 të Ligjit të DHSK-së, dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Me jurisprudencën e pranuar gjerësisht të tribunalëve penalë ndërkombëtarë kërkohet që detyrimi i provës për sjellje të vullnetshme ose

³³ Përgjigje ndaj Mocionit të Prokurorisë, para. 51 (theksimet janë shtuar).

³⁴ *Shih* Rregulla 43(3) e Rregullores; Mocioni i Mbrojtjes, para. 24, 25.

³⁵ Vendimi i Kontestuar, para. 75, 106.

mungesë të veprimeve detyruese gjatë marrjes së deklaratës është detyrim i prokurorisë.³⁶ Nëse Trupi Gjykses e ka përcaktuar dhe zbatuar ligjin saktë në këtë pikë meriton të shqyrtohet nga apeli.

viii. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur ka zbatuar kriterin objektiv nëse i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për të drejtat e tij para secilës intervistë

36. Në paragrafët 70, 73 to 74, 77, 95 deri 97, 100 deri 104 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka vlerësuar nëse i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për të drejtat e tij para intervistave me autoritetet belge. Sidoqoftë, Trupi Gjykses ka gabuar kur ka zbatuar kriterin objektiv nëse i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për të drejtat e tij.³⁷ Konstatimi i Trupit Gjykses bazohet në njoftimin e dhënë në formë të shkruar brenda fletëthirrjes dhe “deklaratës së të drejtave”. Trupi Gjykses ka gjykuar se deklaratat e të akuzuarit, të dhëna gjatë intervistës së vitit 2019, që tregojnë huti, nuk kishin hedhur dyshime nëse ai i kishte kuptuar të drejtat e veta.³⁸ Trupi Gjykses ka konstatuar se ai ishte njoftuar mjaftueshëm sepse ishte njoftuar me shkrim në dokumentet që i ishin dërguar së bashku me fletëthirrjen dhe pa i shqyrtuar deklaratat e tij të dhëna gjatë intervistës në fjalë, të cilat në fakt tregojnë se ai nuk e kishte kuptuar aspak se kishte të drejtë të kishte avokat falas. Për t’u siguruar se garantohet e drejta e të akuzuarit për ndihmë juridike në mënyrë efektive dhe jo vetëm teorikisht, në vlerësimin nëse i akuzuari është njoftuar mjaftueshëm për të drejtat e tij duhet të zbatohet kriteri subjektiv që merr parasysh rrethanat e të akuzuarit konkret, nivelin e arsimimit të tij, aftësinë për t’i kuptuar shprehjet ligjore të ndërlikuara, të drejtat e veta, si dhe çdo deklaratë përkatëse të shprehur qartë.

³⁶ Shih, për shembull, TPNJ, *Prosecutor v. Delalić et al.*, Case No. IT-96-21-T, Decision on Zdravko Mucić’s Motion for the Exclusion of Evidence, 2 shtator 1997, para. 42.

³⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 101.

³⁸ Vendimi i Kontestuar, para. 104.

Zbatimi i kriterit subjektiv konfirmohet edhe nga korniza ligjore e DHSK-së. Rregulla 43(3) e Rregullores parasheh që, “kur e informon të dyshuarin për këtë të drejtë, Prokurori i Specializuar mban parasysh rrethanat personale të të dyshuarit, ndër të tjera moshën dhe gjendjen mendore e fizike të të dyshuarit.” Po ta kishte zbatuar Trupi Gjykses kriterin e duhur, do t’i kishte dhënë më shumë rëndësi deklaratave të të akuzuarit që tregojnë hutinë e tij të plotë në lidhje me situatën dhe të drejtat në fjalë. Kriteri i zbatueshëm është çështje që kërkon shqyrtim nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

ix. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim kur nuk shqyrtoi ose kur zbatoi kriterin objektiv gjatë vlerësimit nëse i akuzuari kishte mundur të parashihte pasojat e veprimeve të veta në lidhje me secilën intervistë

37. Sa i përket intervistës së TPNJ-së të vitit 2005, Trupi Gjykses nuk ka shqyrtuar nëse i akuzuari kishte mundur të parashihte pasojat e veprimeve të veta për qëllime të vlerësimit nëse kishte hequr dorë, pasi ishte informuar mirë dhe në mënyrë të qartë, nga të drejtat e veta si i dyshuar.³⁹
38. Në paragrafin 48 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka vënë në dukje “se i akuzuari ishte informuar për pasojat e mundshme nëse do të jepte këtë intervistë, konkretisht, se deklarata e tij do të incizohej dhe mund të përdorej si provë kundër tij” dhe në bazë të kësaj erdhi në përfundim se “i akuzuari kishte mundur të parashihte në mënyrë të arsyeshme se cilat mund të ishin pasojat e veprimeve të tij.”
39. Në paragrafin 74 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka gjykuar se “i akuzuari është njoftuar thjesht për pasojat e mundshme e dhënies së intervistës, konkretisht, se deklaratat e tij mund të përdreshin si prova në procedura

³⁹ Vendimi i Kontestuar, para. 32-38.

kundër tij” dhe, në këtë bazë, ka ardhur në përfundim “se i akuzuari mund t’i kishte paraparë pasojat e veprimeve të veta”.

40. Në paragrafin 105 të Vendimit të Kontestuar, Trupi Gjykses ka vlerësuar nëse i akuzuari ishte njoftuar mjaftueshëm për pasojat e mundshme të dhënies së intervistës së vitit 2019 në mungesë të avokatit dhe ka ardhur në përfundim se ai ishte i njoftuar mirë për shkak të njoftimit që kishte marrë me fletëthirrjen dhe deklaratën e të drejtave. Në bazë të informacionit të dhënë “përmes fletëthirrjes dhe deklaratës së të drejtave”, Trupi Gjykses ka konstatuar se, “prandaj,” i akuzuari “kishte mundur të parashihte se cilat do të ishin pasojat e veprimeve të veta”.
41. Mbrojtja vë në dukje me respekt se Trupi Gjykses nuk ka shqyrtuar fare nëse i akuzuari e kishte kuptuar natyrën dhe llojin e akuzave që mund të ngriheshin kundër tij dhe dënimin përkatës me të cilin mund të përballej në rast të shpalljes fajtor.
42. Në vlerësimin nëse i akuzuari mund të parashihte pasojat e pjesëmarrjes në intervista pa ndihmë juridike, Trupi Gjykses ka gabuar kur ka zbatuar kriterin objektiv që nuk ka marrë parasysh rrethanat e të akuzuarit, i cili kishte vepruar pa ndihmën e avokatit gjatë tërë kohës. Siç është thënë më lart, zbatimi i kriterit subjektiv kërkohet edhe për të garantuar gjykim të drejtë edhe me rregullën 43(3) të Rregullores që parasheh se “[i] dyshuari mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse Prokurori i Specializuar sigurohet se i dyshuari e kupton rëndësinë e kësaj të drejte dhe pasojat e heqjes dorë prej saj. Kur e informon të dyshuarin për këtë të drejtë, Prokurori i Specializuar mban parasysh rrethanat personale të të dyshuarit, ndër të tjera moshën dhe gjendjen mendore e fizike të të dyshuarit.”

43. Gjithashtu, konstatimi i Trupit Gjykses në lidhje me intervistën e vitit 2019 është bazuar në supozimin se i akuzuari ishte i njoftuar “mjaftueshëm” për të drejtat e tij “përmes fletëthirrjes dhe deklaratës së të drejtave”, pa e marrë parasysh se as oficeri belg e as përfaqësuesi i ZPS-së nuk ia kishin shpjeguar të drejtat para se të fillonte intervista, dhe pa e marrë parasysh arsimimin dhe prejardhjen dhe gjendjen mendore të të akuzuarit, dhe përgjithësisht aftësinë për të kuptuar dhe vlerësuar seriozitetin e situatës në të cilën ishte.

x. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim kur shqyrtoi Mocionin e Mbrojtjes për Përjashtimin e Provave dhe nuk nxori vendim të arsyetuar mjaftueshëm për refuzimin e mocionit

44. Trupi Gjykses ka bërë gabim kur e ka hedhur poshtë Mocionin e Mbrojtjes pa i shqyrtuar parashtrimet e Mbrojtjes në të dhe pa dhënë arsye të mjaftueshme të mjaftueshme për ta mbështetur vendimin.⁴⁰

B. Pikat ndikojnë mjaftueshëm zhvillimin e drejtë të procedurave dhe rezultatin e gjykimit

45. Pikat e evidentuara në paragrafin 4 të kësaj Kërkese prekin thelbin e të drejtave themelore për gjykim të drejtë të mbrojtura me nenin 21 të Ligjit të DHSK-së, nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Nëse Mbrojtja ka të drejtë, gjykimi do të vijojë në kundërshtim me garancitë e parapara me ligjet e Kosovës, kornizën ligjore të DHSK-së, dhe KEDNJ-në. Duke pasur parasysh natyrën cenuese në vetvete të materialit të kontestuar, cenimi i pësuar do të jetë i riparueshëm.

⁴⁰ Vendimi i Kontestuar, para. 18, 114(a).

46. Duke pasur parasysh për sa më lart, Vendimi i Kontestuar përbën ndërhyrje të paligjshme në të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 21 të Ligjit të DHSK-së, nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Pikat e apelueshme ndikojnë drejtpërdrejt në drejtësinë e procedurave dhe rezultatin e gjykimit.

C. Një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Apelit do t'i avanconte materialisht procedurat

47. Një vendim i shpejtë nga Paneli i Apelit do të ofronte siguri në lidhje me nëse procedurat do të vazhdojnë duke respektuar garancitë themelore të drejtësisë. Intervenimi i apelit në këtë fazë do të sigurojë që procedurat të mund të vazhdojnë në një rrugë të ngushtë dhe efektive që respekton të drejtat e të akuzuarit. Nëse Mbrojtja ka të drejtë, pasojat e vazhdimit pa vendim për këto pika në apel do të ishin të pandreqshme.

IV. PËRFUNDIM

48. Për këto arsye, Mbrojtja kërkon me respekt nga Trupi Gjykes që ta miratojë kërkesën dhe të vërtetojë pikat e propozuara në paragrafin 4.

Numri i fjalëve: 6125

Parashtruar me respekt,

/nënshkrimi/

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtës i Specializuar

_____/nëshkrimi/_____

Hedi Auini

Bashkëmbrojtës

_____/nëshkrimi/_____

Leto Kariolu

Bashkëmbrojtës

E martë, 13 dhjetor 2022

Hagë, Holandë

UNREVISSED